


SI PRITET TË VEPROJË VAKSINA MEBAZË ARN-mesazhere (=mARN)

Vaksinat më premtuese kundër COVID-19, që kanë avancuar në fazat e fundit të provave klinike janë ato gjenetike, të bazuara ARN mesazhere (mARN)

Efektiviteti i vaksinave


(në përqindje)



Duke qenë se efektiviteti i vaksinës së gripit stinor varion me kalimin e kohës, është paraqitur një mesatare e 10 viteve të fundit. Të dhënat janë grumbulluar dhe përmbledhur nga burime të ndryshme si CDC, OSH, FT, DB, NCBI, NHS dhe ISHP

1. Vaksinat klasike, si ato kundër fruthit apo poliomiellit, administrohen përmes inokulimit të pacientit me një version të dobësuar ose 'të vrarë' (=ç'aktivizuar) të virusit. Ky inokulum nxit sistemin imun të prodhojë antitropa të specializuar, që janë përshtatur për të njohur agjentin e ri sëmundjeshkaktues (në këtë rast virusin SARS-CoV-2).


2. Më pas, antitropat qëndrojnë në trup gati për të neutralizuar agjentin në sulmin potencial të rradhës. Nëse pacienti infektohet me virusin në fjalë, atëherë antitropat mund ta identifikojnë dhe të ndihmojnë në shkatërrimin e ti efektiv.



Vaksinat me bazë mARN
Në vend që të përdoret e gjithë grimca virale për të gjeneruar një përgjigje imunitare, këto vakcina përdorin vetëm proteinat e jashtme të gjilpërës, të cilat janë 'shënjestra' e antitropave.

Kërkuesit shkencorë kanë izoluar tashmë gjenet përgjegjëse për prodhimin e gjilpërave të koronavirusit të ri. Këto gjene janë të 'paketuara' në një veshje yndyrore, që i ndihmon të mos dëmtohen apo degradohen.


Kur jepet vakcina, këto gjene futen në qelizat e shëndetshme, brenda të cilave sinjalizojnë prodhimin e proteinave të gjilpërës së koronavirusit të ri.



Në momentin që dalin nga qeliza, proteinat e gjilpërës nxisin sistemin imunitar që të prodhojë një përgjigje mbrojtëse, njësoj si në rastin e vaksinave klasike.

Krijuar nga ekipi i **Heda** bazuar në Nature dhe USJ
ASISTENTJA E SHËNDETIT TUAJ


Faza që duhet ende të kalojë...



Sfida logjistike dhe një model potencial për ti adresuar ...

1 Këto vakcina do të transportohen në 'kontenjerë termal' në mënyrë që ta mbajnë temperaturën në minus 70°C për afro 10 ditë. Çdo pako përmban 1000 deri në 5000 doza

2 Këto kontenjerë do të jenë të pajisur me gjurmues GPS dhe mund të hapen vetëm 2-4 herë në ditë, për vetëm një minutë/herë.



3 Pas shkrirjes, dozat duhet të ruhen në frigorifer normal për rreth 5 ditë.

4 Dozat mund të transportohen në qendrat ditore për të moshuarit, qendrave të vaksinimit dhe qendra shëndetësore.

5 Në këtë moment nëse vakcina do të jetë e suksesshme në të gjitha fazat e aprovimit dhe logjistikës, atëherë do duhet të përcaktohet programi dhe prioritetet e vaksinimit.